




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVO
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I PËRFORMANCËS I AGJENCISË SË PUNËSIMIT TË REPUBLIKËS SE KOSOVËS PËR VITIN 2025

Janar 2026

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti Vjetor i Performancës i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) për vitin 2025 paraqet një vlerësim të zbatimit të Planit të Performancës, duke analizuar progresin e objektivave dhe efikasitetin e shërbimeve të punësimit dhe aftësimit profesional. Ky raport shërben si një mjet kyç për monitorimin dhe matjen e rezultateve institucionale, në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara në **Rregulloren nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore**.

Plani i Performancës i APRK-së përfaqëson një instrument strategjik të dakorduar ndërmjet Agjencisë dhe njësisë përgjegjëse dhe **Ministritë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)**, i cili miratohet çdo fundvit dhe monitorohet rregullisht për të siguruar përmbushjen e objektivave të përcaktuara. Për të garantuar një proces të mirëorganizuar të raportimit dhe analizës, është krijuar një grup punues i përbërë nga përfaqësues të njësive përgjegjëse të Agjencisë, të mandatuara për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave si dhe hartimin e këtij raporti.

Raporti reflekton një analizë të performancës së institucionit, duke vlerësuar **treguesit kryesorë**, arritjet dhe sfidat e hasura gjatë vitit 2025. Përveç një **pasqyre të detajuar mbi rezultatet e planifikuara dhe të realizuara**, raporti përmban edhe **shënime shpjeguese mbi faktorët që kanë ndikuar në mosarritjen e disa objektivave, si dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të proceseve**.

Për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, është zbatuar **forma standarde e raportimit** e përcaktuar në **Rregulloren nr. 12/2023**. Ekipi përgjegjës ka administruar procesin e raportimit në nivel institucional, duke siguruar koherencë dhe saktësi në përpunimin e informatave.

Raporti trajton një gamë të gjerë të treguesve që reflektojnë **avancimin dhe zgjerimin e shërbimeve publike të punësimit**, përfshirë **masat aktive të tregut të punës**, me fokus në ndikimin e tyre në rritjen e punësueshmërisë, **shërbimet e aftësimit profesional**, duke vlerësuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e tyre me kërkesat e tregut të punës, si dhe **zhvillimet institucionale**, duke përfshirë **integrimin e sistemeve digjitale, ngritjen e kapaciteteve, përmirësimin e infrastrukturës dhe menaxhimin e burimeve financiare**.

Në aspektin, **ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të infrastrukturës fizike**, vazhdojnë të ekzistojnë sfida që kërkojnë qasje strategjike me të avancuar.

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe raportimet nga njësitë përkatëse, realizimi i rezultateve (outputeve) është klasifikuar në tri kategori kryesore:

1. **E përfunduar** – rezultatet (outputet) që janë arritur në përputhje me planin e performancës;
2. **Pa përfunduar** – rezultatet që nuk janë përmbushur, me shënime shpjeguese mbi shkaqet dhe rrethanat..
3. **Pjesërisht** – rezultatet që kanë shënuar progres, por nuk janë përmbushur plotësisht për shkak të faktorëve të ndryshëm;

Kësisoj sipas gjetjeve të raportit del se, nga 29 rezultatet të parapara të Planit të Përfomances:

- **22 apo 75.86% e rezultateve të planifikuara janë përfunduar;**
- **3 nuk janë përfunduar, duke përbërë 10.34% dhe**
- **13.79%% janë realizuar pjesërisht, apo 4 nga 29 rezultatet e planifikuara**

Hyrje

Ky raport synon të ofrojë një pamje të qartë lidhur me shkallën e zbatueshmërisë së Planit në raport me indikatorët dhe rezultatet e synuara. Si i tillë raporti si instrument i rëndësishëm i përcaktimit të nivelit të zbatimit Planit të Performances, synon t'i ofrojë përpiluesve dhe zbatuesve një pasqyrë objektive lidhur me progresin, duke identifikuar poashtu edhe fushat në të cilat ka pasur ngecje. Pra, raporti shërben, ndër tjerash, si udhërrëfyes për përshpejtimin e realizimit të objektivave të planit në fushat ku kërkohet përparim më i madh.

Përpilimi i këtij raporti bazohet në një metodologji të qartë, i cili ka siguruar një përfshirje të akterevë zbatues. Nën udhëheqjen e grupit punues, është administruar procesi i vjeljes së informatave nga departamentet dhe institucionet gjegjëse të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e Planit të Performancës.

Përpilimi i këtij raporti të monitorimit hyn në kuadër të kërkesave formale të Drejtorit të Përgjithshëm të APRK, i cili ka autorizuar grupin punues për përgatitjen e Raportit të Performances së APRK për vitin 2025. Grupi Punues, me përbërje të njësive dhe departamenteve gjegjëse të APRK, ishte i obliguar ta vlerësoj zbatimin e Planit dhe më pas të dorëzoj raport lidhur me përmbushjen e objektivave.

Për më tepër, ky raport është konform përgjegjësisë të përcaktuara sipas legjislacionit sekondar. Respektivisht, raporti vjetor bëhet në bazë të Rregullores nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, e cila përcakton standardet dhe kriteret për monitorimin dhe raportimin e performancës së agjencive ekzekutive. Kjo rregullore ofron një kornizë të dobishme lidhur me mënyrën e përpilimit të raportit vjetor për zbatimin e Planit të Performances. Sipas kësaj rregulloreje, raporti duhet të përshkruajë nivelin e përmbushjes së objektivave bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e pritshme të përcaktuara në Planin e Performancës, por edhe të bëjë identifikimin e fushave të cilat kanë nevojë për përmirësim në zbatim, si dhe të paraqes realizimin e buxhetit.

Në këtë kontekst, raporti synon të ofrojë një bazë të fuqishme për vendimmarrje, duke ndihmuar përpiluesit dhe zbatuesit e politikave të punësimit në **identifikimin e fushave ku nevojiten ndërhyrje të mëtejshme** dhe në hartimin e strategjive për përmirësimin e mëtejshëm të performancës institucionale.

Duke marrë parasysh rëndësinë e **transparencës dhe llogaridhënies publike**, ky raport është një dokument i rëndësishëm për të gjitha palët e interesit, përfshirë institucionet qeveritare, partnerët ndërkombëtarë, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët. Ai synon të nxitë një qasje interaktive më efektive dhe të qëndrueshme për adresimin e sfidave të tregut të punës dhe promovimin e punësimit cilësor.

Metodologjia

Matja e shkallës së zbatueshmërisë së Planit të Performances për këtë raport bazohet ekskluzivisht mbi raportimin e brendshëm nga ana e anëtareve të ekipit. Njësitë, departamentet, të cilat janë përfshirë në raportim janë sipas autorizimit të Drejtorit të Përgjithshëm të APRK, sipas të cilit edhe është caktuar Grupi Punues për përgatitjen e Raportit të Performances së APRK për vitin 2025.

Forma e raportimit është përgatitur sipas kërkesave formale dhe ligjore të përcaktuara me legjislacion. Forma e raportimit është përshtatur duke u bazuar në Planin e Performances, e cila është përgatitur në formatin (ëord) dhe janë specifikuar kolonat për të cilat akteret gjegjës është dashur të raportojnë. Këto kolona kanë përfshirë kërkesën që njësitë gjegjëse përkatësisht grupi i punës të raportojnë: Nëse rezultatet e planifikuara kanë përfunduar gjatë vitit 2025. Forma e raportimit ka përfshirë edhe raportimin mbi vlerat e synuara të tregueseve. Po ashtu standardi i raportimit ka përfshirë edhe pjesën e shënimeve shpjeguese, lidhur me rrethanat që kanë ndikuar në mos arritjen e rezultateve të synuara.

Mënyra e raportimit nga anëtarët e grupit punues është bazuar në dërgimin e inputeve përmes postës elektronike. Udhëheqësi i GP ka dërguar format e raportimit (sipas strukturës së përshkruar më lart) përmes emailit tek të gjithë anëtarët e grupit për përgatitjen e Raportit të Performances. Pas dërgimit të formave të plotësuara, sipas afatit të përcaktuar, grupi punues ka konsoliduar inputet në një dokument të vetëm dhe është zhvilluar analiza. Analiza e inputeve është shoqëruar me konsultime tematike ndërmjet anëtarëve të grupit punues me qëllim që të dhënat e ofruara të jenë me të plota dhe të bazuara në dëshmi.

Përgjithësisht, raportimi nga ana e akterëve gjegjës është kufizuar në raportimin e rezultateve dhe treguesve gjatë vitit 2025. Ndërkaq në ciklet e ardhshme raportuese raporti duhet të jete me ambicioz në kuptim të ofrimit të informatave sa i përket shpenzimit të buxhetit për secilin veprim, duke përfshirë rekomandimet për përmirësimin e Planit të Performances, identifikimin e rreziqeve, pengesave dhe adresimin e problemeve të hasura gjatë zbatimit. Megjithatë, ky raport ofron mjaftueshëm informata për të pasur një pasqyrë të qartë lidhur me zbatueshmërinë e Planit të Performances për vitin 2025.

Figura 1: Procesi i përgatitjes të Raportit të Përformancës 2025



Përmbledhje statistikore – Gjetjet kryesore


Pasqyrë e përgjithshme e realizimit të rezultateve gjatë 2025

Vlerësimi i realizimit të rezultateve dhe të treguesve bazohet ekskluzivisht në raportimet nga ana e anëtarëve të grupit punues. Bazuar në inputin e anëtarëve të grupit punues të cilët përfaqësojnë njësitë përkatëse të APRK, të gjitha rezultatet janë vlerësuar sipas kategorive kryesore. Më saktësisht, janë përcaktuar këto kategori të vlerësimit:

1. **E Përfunduar** – e aplikuar në rastet kur rezultatet gjykohen të jenë realizuar;
2. **Pa përfunduar** – e aplikuar në rastet kur nuk janë realizuar rezultatet e planifikuara;
3. **Pjesërisht** – është aplikuar në rastet kur është shënuar progres, mirëpo nuk janë përbushur plotësisht për shkak të faktorëve të ndryshëm;

Sipas vlerësimit të zbatimit të Planit të Performances, shumica e rezultateve gjatë 2025 janë cilësuar si **“E përfunduar”**. Nga gjithsej 29 rezultate të parapara të Planit të Performances, 22 rezultate, apo 75.86% u realizuan. Tre (3) rezultate **nuk janë realizuar**, që përbën 10.34%. Ndërkaq 13.79% janë realizuar pjesërisht, apo 4 nga 29 rezultatet e planifikuara. Për me tepër informata shih figurën 2.¹

Figura 2. Paraqet përqindjen e realizimit të rezultateve të planifikuara për vitin 2025



Burimi i raportimit dhe klasifikimi nga anëtarët e grupit punues.

¹Sqarim disa nga rezultatet të cilat kanë shkallë të larte të realizimit në kuptim të përqindjes (psh nga 60 deri 85%) janë cilësuar si të realizuara.

Aktivitetet sipas kategorizimit “ Përfunduar” dominojnë sipas objektivave në kuadër të Planit të Punës

- Në kuadër të Objektives se pare të Planit të Punës, **8 rezultate (outpute) u realizuan plotësisht, 2 nuk janë realizuar;;**
- Në kuadër të Objektives se dytë; **6 rezultate u realizuan plotësisht; dhe nuk pa përfunduar apo pjesërisht;**
- Sa i përket Objektives se trete – **janë realizuar 5 rezultate, 1 nuk është realizuar dhe 4 janë cilësuar si pjesërisht**
- Lidhur me Objektiven e katërt – **3 rezultate janë përfunduar, dhe nuk pa përfunduar apo pjesërisht;**
-

Për më shumë shih figurën 3 dhe Tabelën 1.

Figura 3:





Tabela 1: Realizimi i rezultateve (outputeve) sipas objektivave:

Objektivat	Përfunduar	Pa përfunduar	Pjesërisht	Total
Objektivi 1	8	2	0	10
Objektivi 2	6	0	0	6
Objektivi 3	5	1	4	10
Objektivi 4	3	0	0	3
Total	22	3	4	29

Figura 4: Realizimi i rezultateve të Planit të Punës sipas kategorive shprehur në përqindje (%)



Realizimi i rezultateve sipas objektivave

OBJEKTIVA 1: Avancimi dhe zgjerimi i ofrimit të shërbimeve të punësimit, masave aktive dhe mobilitetit në tregun e punës

Realizimi i rezultateve

Rezultatet në kuadër të kësaj objektivë, shumica janë cilësuar si të përfunduara sipas realizimit të tyre. Lidhur me këtë objektiv janë planifikuar 10 rezultate. Nga ky numër rezultate të cilat cilësohen si të përfunduara janë 8, të pa përfunduara 2.

Rezultatet të cilat u përfunduan plotësisht, dhe atë:

- **Këshillimi në Punësim i 22,000 punëkërkesve.**

Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 186.8%. Realizimi i këtij aktiviteti është tejkaluar pasi që me aktivizimin e përfituesve të SAS-it është rritur edhe numri i këshillimeve në punësim. Numri i këshillimeve në punësim gjatë këtij viti ka qenë 57,363.

- **Këshillimi në Karrierë i 22,000 punëkërkesve.**

Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 154.3%. Realizimi i këtij aktiviteti është tejkaluar pasi që me aktivizimin e përfituesve të SAS-it është rritur edhe numri i këshillimeve në karrierë. Numri i këshillimeve në karrierë gjatë këtij viti ka qenë 50,865.

- **Ndërmjetësimi në Punësim i 4,400 personave në tregun e punës përmes platformave online të Skemave të Punësimit nga pako e ringjalljes ekonomike**

Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 157%. Realizimi i këtij aktiviteti është tejkaluar, ku numri i përfituesve në skemën e punësimit ka qenë: superpuna 9,639 dhe KgenU 641 persona.

- **Ndërmjetësimi në Punësim i 2,200 personave në tregun e punës përmes Punësimit të Rregullt**

Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 37.6%. Numri i punëkërkesve të cilët kanë përfituar përmes Ndërmjetësimit të Rregullt në punësim është 2,752 persona.

- **Ndërmjetësimi në Punësim i 2,200 personave në tregun e punës përmes MATP.**

Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 6.45%. Numri i punëkërkesve të cilët kanë përfituar përmes MATP është 2,129 persona

- **240 Leje afatshkurtër të lëshuara.**

Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 176%. Numri i lejeve të punës afatshkurtër për shtetasit e huajt është 552 leje pune afatshkurtër të lëshuara

- **Pagesa të bëra për 8,800 lehona.**

Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 33.1%. Numri i përfitueseve Lebona me status punësimi është 3860 persona. Kurse në aspektin buxhetor apo të pagesave janë bërë për secilin përfitues nga 3 pagesa dhe gjithsejtë janë 11580 ose 31.6% më shumë.

- **Numri i punëkërkuarve të referuar**

Përqindja e realizimit të këtij rezultati është 78.9%. Rezultati nuk është arritur plotësisht për arsye të mungesës së kandidatëve të interesuar për ngritje të shkathtësive profesionale.

Detajet shpjeguese lidhur me rezultatet **“pa përfunduar”** gjenden në shtojcën 1 të këtij dokumenti.

OBJEKTIVA 2: Ofrimi i shërbimeve cilësore të aftësimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Realizimi i rezultateve

Në kuadër të kësaj objektive janë planifikuar 6 rezultate. **Nga 6 rezultatet e planifikuara u realizuan të gjitha.**

Janë 6 rezultate të cilat u përfunduan dhe atë:

1. Aftësimi dhe riaftësimi i 2400 të papunëve për tregun e punës,
2. Dhjetë (10) profile të qendrave të aftësimit profesional të rifunksionalizuara për ofrim të shërbimeve të AP
3. Tri (3) Kurrikula të hartuara sipas standardeve të profesionit në harmoni me kërkesat e tregut të punës
4. 8 Kualifikime të Validuara në Qendrat e Aftësimit Profesional
5. 7 QAP të Akredituara dhe 9 kualifikime të validuara për ofrim të Njohjes së Mësimit Paraprak (NJMP)
6. Qendrat e Aftësimit profesional janë furnizuar me pajisje dhe vegla pune për të ofruar shërbime cilësore të aftësimit profesional

Shënime shpjeguese dhe detaje të tjera janë ofruar në shtojcën 1 të këtij raporti.

OBJEKTIVA 3: Avancimi i sistemit digjital të shërbimeve informative te punësimit, krahas përmirësimit të infrastrukturës fizike për ZP dhe QAP.

Realizimi i rezultateve

Rezultatet në kuadër të kësaj objektive, shumica janë cilësuar si të përfunduara sipas realizimit të tyre. Lidhur me këtë objektiv janë planifikuar 10 rezultate. **Nga ky numër rezultate të cilat cilësohen si të realizuar janë 5 rezultate, 1 nuk është realizuar, 4 janë cilësuar si pjesërisht**

1. Zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrjetore dhe harduerike
2. Platforma e Aftësimit Profesional e funksionalizuar për trajnerët dhe punëkërkuarët dhe ndërlidhja me sistemin e ri
3. Zyrat e Punësimit të renovuara dhe të brenduara
4. Objektet e renovuara të QAP-ve
5. Dokumenti i KASH-it i planifikuar

Detajet shpjeguese lidhur me rezultatet gjinden në shtojcën 1 të këtij dokumenti.

OBJEKTIVA 4: Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimi i burimeve njerëzore

Realizimi i rezultateve të objektives 4

Në kuadër të kësaj objektive janë planifikuar 3 rezultate. **Ndërkaq sa i përket realizimit të tyre, të gjitha apo 3 nga këto janë përfunduar.**

Janë 3 rezultate të cilat përfunduan:

1. Plani i miratuar për ngritjen e kapaciteteve dhe rekrutimin e stafit të ri
2. Raporti mujor mbi progresin e zbatimit të planit dhe rekrutimit
3. Raporti vjetor i ndikimit të trajnimeve dhe rekrutimeve në performancën e stafit

Detajet shpjeguese lidhur me rezultatet gjinden në shtojcën 1 të këtij dokumenti.

Përfundimi

Raporti i performancës evidenton një shkallë realizimi prej rreth 75.86% të objektivave të përcaktuara, ku një pjesë e tyre janë përmbushur pjesërisht, ndërsa një numër i kufizuar kanë mbetur të parealizuara. Këto të dhëna dëshmojnë se, megjithëse është shënuar progres i konsiderueshëm në disa fusha, vazhdojnë të ekzistojnë sfida që kanë ndikuar në zbatimin e plotë të planit të punës.

Kjo situatë nënvizon nevojën për një analizë më të detajuar të faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizimin e plotë të objektivave, si dhe për një integrim më të mirë të tyre në ciklet e ardhshme të planifikimit. Mosarritja e disa rezultateve është pasojë e një sërë faktorësh, përfshirë çështje administrative, kufizime në kapacitetet njerëzore dhe financiare, si dhe vonesa në zbatimin e disa masave ligjore nga njësitë përgjegjëse.

Përmes kategorizimit të nivelit të zbatimit, raporti ka identifikuar qartë fushat ku nevojitet angazhim më i madh institucional, me qëllim arritjen e rezultateve më të plota dhe më të qëndrueshme.

Në ciklet e ardhshme të raportimit, është e domosdoshme të sigurohet një qasje më gjithëpërfshirëse dhe cilësore nga njësitë përgjegjëse, duke përfshirë raportim më të detajuar mbi shpenzimet buxhetore, nevojat për përmirësim, identifikimin e pengesave dhe propozimin e masave korrigjuese.

Po ashtu, mbetet thelbësore përmirësimi i indikatorëve të performancës, në mënyrë që ata të jenë më realistë, të matshëm dhe në përputhje me kapacitetet institucionale.

Në përgjithësi, raporti thekson rëndësinë e një qasjeje më të koordinuar dhe proaktive për realizimin efektiv të objektivave. Njëkohësisht, ai ofron bazë për reflektim dhe përmirësim të vazhdueshëm të proceseve të planifikimit dhe zbatimit, duke e orientuar APRK-në drejt një performance më të avancuar dhe një ndikimi më të madh në tregun e punës.

Shtojca 1:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVO
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I PËRFORMANCËS I AGJENCISË SË PUNËSIMIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2025

Data:	28.01.2026					
APRK						
MFPT						
Misioni i APRK	Misioni i Agjencisë është ulja e inaktivitetit, rritja e punësimit, zhvillimi i shkathhtësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe administrimi më i mirë i tregut të punës.					
Objektivat	Treguesit	Vlera e synuar	Vlera faktike	Rezultat (outputet) e planifikuara	Rezultatet (outputet) e përfunduara (Po/JO)	Shënim shpjegues

Avancimi dhe zgjerimi i ofrimit të shërbimeve të punësimit, masave aktive dhe mobilitetit në tregun e punës	Udhëzuesit Operacional për Ofrimin e Shërbimeve të Punësimit i ri-dizajnuar	1	-	Ri hartimi i udhëzuesit operacional të shërbimeve të punësimit i përfunduar	JO	Nuk është miratuar Ligji për Nxjitjen e Punësimit andaj nuk është filluar ri-hartimi i udhëzuesit operacional për shërbime të punësimit
	Numri i të papunëve të regjistruar që përfitojnë nga këshillimi për Punësim.	(Vlera baze 20,000) 10%	57,363	Këshillimi në Punësim i 22,000 punëkërkuessve.	PO	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 186.8%. Realizimi i këtij aktiviteti është tejkaluar pasi që me aktivizimin e përfutuesve të SAS-it është rritur edhe numri i këshillimeve në punësim. Numri i këshillimeve në punësim gjatë këtij viti ka qene 57,363.
	Numri i të papunëve të regjistruar që përfitojnë nga këshillimi për Karrierë.	(Vlera baze 20,000) 10%	50,865	Këshillimi në Karrierë i 22,000 punëkërkuessve.	PO	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 154.3%. Realizimi i këtij aktiviteti është tejkaluar pasi që me aktivizimin e përfutuesve të SAS-it është rritur edhe numri i këshillimeve në karriere. Numri i këshillimeve në karrierë gjatë këtij viti ka qene 50,865.
	Numri i të papunëve që ndërmjetësohen në skema tjera të punësimit përmes platformave online	(Vlera baze 4,000) 10%	10,280	Ndërmjetësimi në Punësim i 4,400 personave në tregun e punës përmes platformave online të Skemave të Punësimit nga pako e ringjalljes ekonomike	PO	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 157%. Realizimi e këtij aktiviteti është tejkaluar , ku numri i përfutuesve në skemën e punësimit ka qene: superpuna 9,639 dhe KgenU 641 persona.
	Numri i të papunëve që ndërmjetësohen në punësim të rregullt.	Vlera baze 2000) 10%	2,752	Ndërmjetësimi në Punësim i 2,200 personave në tregun e punës përmes Punësimit të Rregullt	PO	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 37.6%. Numri i punëkërkuessve të cilët kanë përfutuar përmes Ndërmjetësimit të Rregullt në punësim është 2,752 persona.
	Numri i të papunëve që ndërmjetësohen në MATP	Vlera baze 2000) 10%	2,129	Ndërmjetësimi në Punësim i 2,200 personave në tregun e punës përmes MATP	PO	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 6.45%. Numri i punëkërkuessve të cilët kanë përfutuar përmes MATP është 2,129 persona

	Udhëzuesi i shërbimeve të migracionit për çështje punësimi për shtetasit e huaj 30,60 dhe 90 dite dhe konfirmim të Lejeve të Punës me qëllim të punësimit nga DSHAM	2	-	Udhëzuesi i përfunduar për shërbimet e migracionit për çështje punësimi për shtetasit e huaj 30,60 dhe 90 dite dhe konfirmim të Lejeve të Punës me qëllim të punësimit nga DSHAM	JO	Nuk është miratuar Ligji i ri për të Huajt, kështu që nuk është filluar me hartimin e udhëzuesit për shërbime të migracionit për çështje punësimi.
	Numri i lejeve të punës afatshkurtër për të huajt	(vlera bazë 200) 20%	552	240 Leje afatshkurtër të lëshuara.	PO	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 176%. Numri i lejeve të punës afatshkurtër për shtetasit e huajt është 552 leje pune afatshkurtër të lëshuara
	Numri i përfituesve Lehona “me status të punësuar”	Vlera bazë 8000) plus 10%	11580	Pagesa të bëra për 8,800 lehona	PO	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është tejkaluar për 33.1%. Numri i përfituesve Lehona me status punësimi është 3860 persona. Kurse në aspektin buxhetor apo të pagesave janë bërë për secilin përfitues nga 3 pagesa dhe gjithsejtë janë 11580 ose 31.6% me shume.
	Numri i Referimeve në QAP	Vlera bazë 2800) 10%	2210	Numri i punëkërkuarve të referuar	PO	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është 78.9%. Rezultati nuk është arritur plotësisht për arsye të mungesës së kandidatëve të interesuar për ngritje të shkallësive profesionale.
	Ofrimi i shërbimeve cilësore të aftësimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	2400	1915	Aftësimi dhe riaftësimi i 2400 të papunëve për tregun e punës,	Po	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është 79.8%. Rezultati nuk është arritur plotësisht për shkak të mungesës së trajnerëve në kabinetet e trajnimit në QAP-a, çka ka ndikuar në kufizimin e kapaciteteve për trajnim.

Profilat e Qendrave të Aftësimit Profesional të ri-funksionalizuara	10	26	Dhjetë (10) profile të qendrave të aftësimit profesional të rifunksionalizuara për ofrim të shërbimeve të AP	Po	
	3	4	Tri (3) Kurrikula të hartuara sipas standardeve të profesionit në harmoni me kërkesat e tregut të punës	Po	
	8	7	8 Kualifikime të Validuara në Qendrat e Aftësimit Profesional	Po	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është 87.5%. Nga 8 kualifikime të planifikuara për validim në Qendrat e Aftësimit Profesional, janë realizuar 7.
	9	9	7 QAP të Akredituara dhe 9 kualifikime të validuara për ofrim të Njohjes së Mësimit Paraprak (NJMP)	Po	Sa i përket çështjes së aplikimit, që na përket neve si APRK, i kemi dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm. Realizimi i mëtejshëm i këtij aktiviteti varet ekskluzivisht nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, i cili shqyrton dhe miraton akreditimet dhe validimet.
	7	7	Qendrat e Aftësimit profesional janë furnizuar me pajisje dhe vegla pune për të ofruar shërbime cilësore të aftësimit profesional	Po	
	1	1	SIMP i digitalizuar sipas shërbimeve të punësimit	Pjesërisht	Është zhvilluar Koncepti Dokumenti për digitalizim të shërbimeve të punësimit si dhe është kontraktuar kompania për zhvillimin e webplatformës e-punësimi. Platforma është në proces të zhvillimit.
Avancimi i sistemit digital të shërbimeve informative të punësimit, krahas përmirësimit të					

infrastrukturës fizike për ZP dhe QAP.	Avancimi i infrastrukturës rrjetore dhe harduerike ne ZP, QAP dhe ZQ/APRK i përfunduar	15	15	Zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrjetore dhe harduerike	Po	
	Instalimi i Sistemit monitorues vizual në zonat e pritjes se ZP dhe QAP i përfunduar	41	-	Instalimi i Sistemit monitorues vizual në zonat e pritjes se ZP dhe QAP	JO	Ky aktivitet nuk është zhvilluar për arsye të mbrojtjes dhe sigurisë se të dhënave për klient (Punëkërkuës dhe Punëdhënëës). Do të bëhet një analizë me e thellë para se të bëhet instalimi i sistemit monitorues.
	Subsistemi për integrimin e data bazave ndërmjet APRK dhe DSHAM si sistemeve tjera relevante	1	1	Subsistemi për integrimin e data bazave ndërmjet APRK dhe DSHAM si dhe sistemeve tjera relevante i zhvilluar	Pjesërisht	Koncepti është zhvilluar mirëpo moduli për punësimin e shtetasve të huaj do të dizajnohet në kuadër të zhvillimit të ëëbpaltformës e-punësimi.
	Digjitalizimi i proceseve për menaxhimin e pagesave për pushimin e lehonisë	1	1	Softueri (databazave) për menaxhimin e procesit te pagesave për pushimin e lehonisë i zhvilluar	Pjesërisht	Koncepti është zhvilluar mirëpo moduli për Lehona do të dizajnohet ne kuadër të zhvillimit të ëëbpaltformës e-punësimi.
	Digjitalizimi i proceseve për menaxhimin e burimeve njerëzore	1	1	Softuer-it (data bazës) për menaxhimin e burimeve njerëzore;	Pjesërisht	Kompania kontraktuar është në finalizim të sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
	Platforma e Aftësimit Profesional e zhvilluar	1	1	Platforma e Aftësimit Profesional e funksionalizuar për trajnerët dhe punëkërkuësit dhe ndërli dhja me sistemin e ri	Po	
	Renovimi dhe Brandimi i ZP Rajonale	4	3	Zyrat e Punësimit të renovuara dhe të brenduara	Po	Përqindja e realizimit të këtij rezultati është 75%.
	Qendrat e Aftësimit Profesional të Renovuara	3	3	Objektet e renovuara të QAP-ve	Po	

Planifikimi i buxhetit dhe Pasqyrave financiare ne Dokumentin e KASH-it	1	1	Dokumenti i KASH-it i planifikuar	Po	
Ngjitja e kapaciteteve profesionale dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	1	1	Plani i miratuar për ngritjen e kapaciteteve dhe rekrutimin e stafit të ri	Po	
Raporti mujor mbi progresin e planit dhe rekrutimin	12	12	Raporti mujor mbi progresin e zbatimit të planit dhe rekrutimit	Po	
Raporti vjetor i trajnimeve dhe rekrutimeve	240	131	Raporti vjetor i ndikimit të trajnimeve dhe rekrutimeve në performancën e stafit	Po	Edhe pse janë trajnuar 131 zyrtar, një pjesë e tyre kanë ndjekur më shumë se një trajnim, duke rritur numrin total të pjesëmarrjeve. Për këtë arsye, nëse merret për bazë numri i pjesëmarrjeve në trajnime, objektivi prej 240 pjesëmarrjesh konsiderohet i arritur dhe i tejkaluar.


U.D. Drejtori i APRK